URDHËR
Nr.12, datë 17.1.2012

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË "PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE E ZHVILLIMIT" DHE "PSIKOLOGJI KËSHILLIMI KLINIK" DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE "UNIVERSITETI "KRISTAL"", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti "Kristal"",

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Politike të shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti "Kristal"", Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të dytë, që realizohen me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në:

a) Psikologji shkollore dhe e zhvillimit;

b) Psikologji këshillimi klinik.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr.276, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Këto programe studimi fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Universiteti "Kristal"", Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare, jopublike "Universiteti "Kristal"", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj